Kronikë

Theu arrestin shtëpiak dhe tentoi të vrasë ish-gruan dhe bashkëjetuesin e saj, arrestohet 34-vjeçari në Sarandë

Pasi theu arrestin shtëpiak, 35 vjeçari Kleo Hysi u nis nga Kalivaçi i Tepelenës drejt Sarandës për të vrarë ish-gruan dhe bashkëjetuesin e tij, por u kap në kohë nga policia. Përveç Hysit, blutë ndaluan edhe partnerin e gruas, të cilit iu gjet një armë e ftohtë

Shkoi për të vrarë ish-bashkëshorten në Sarandë, kush është 34-vjeçari, i arrestuar për vjedhje me dhunë

Redaksia
10 Korrik, 15:17 | **Përditesimi i fundit: 10 Korrik, 16:42**

SARANDË- Një krim në familje u parandalua sot në Sarandë, kur Kleo Hysi, 34-vjeç, ka thyer masën e 'arrestit në shtëpi', dhe ka tentuar që të vrasë ish-bashkëshorten e tij dhe partnerin e saj.

Pasi është njoftuar, se në lagjen nr.4 në Sarandë, Kleo Hysi kishte konflikt me ish-bashkëshorten 31 vjeçe dhe bashkëjetuesin e saj, Isuf Jaçaj, të cilët i kërcënonte se do t'i vriste me armë zjarri, policia ka ndërhyrë, duke parandaluar ngjarjen e rëndë.

LEXO EDHE:
Zjarr në Finiq të Sarandës, digjen pemë e vreshta! (VIDEO)

Policia ka vënë në pranga Kleo Hysin, i cili kishte thyer masën e sigurisë "Arrest në shtëpi", të caktuar për vjedhje me dhunë.

Gjatë kontrollit fizik, atij iu sekuestrua një pistoletë me fishekë në fole, gati për qitje. Po gjatë këtij operacioni, u bë dhe arrestimi në flagrancë bashkëjetuesit të gruas Isuf Jaçaj, 55 vjeç, pasi iu gjet dhe iu sekuestrua një armë e ftohtë.

Kleo Hysi, rezulton të jetë arrestuar në vitin 2020 për vjedhje me dhunë në bashkëpunim, ku pasi ka dhunuar 91-vjeçarin Dhimitër Papa, i ka marrë atij 20 mijë lekë dhe një armë gjahu. Nuk dihet se si Hysi ka dalë nga burgu në një kohë kaq të shkurtër, duke shkelur më pas edhe masën e sigurisë. Gjykata e Sarandës e kishte lënë në 'arrest shtëpie' në banesën e tij në Kalivaç, Tepelenë.

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 15:29

Shkoi për të vrarë ish-bashkëshorten në Sarandë, kush është 34-vjeçari, i arrestuar për vjedhje me dhunë



1 / 6

Kleo Hysi

34-vjeçari Kleo Hysi, ka thyer masën e 'arrestit në shtëpi', dhe ka tentuar që të vrasë ish-bashkëshorten e tij dhe partnerin e saj, por ngjarja është parandaluar nga policia.

Kleo Hysi, është arrestuar në 2020 për "vjedhje me dhunë në bashkëpunim", ku pasi ka dhunuar 91-vjeçarin Dhimitër Papa, i vodhën atij 20 mije lek të reja dhe një arme gjahu "Baikal" ruse kalibër 12 mm. Nuk dihet se si Hysi ka dalë nga burgu në një kohë kaq të shkurtër.

Mësohet se 34 vjeçari Kleo Hysi ka shkelur masën e sigurise. Gjykata e Sarandës e kishte lënë në Arrest shtëpie në banesën e tij në Kalivaç, Tepelenë.

M.Q./LR/Shqiptarja.com

TAG: Vlore sarande kleo hysi

Komento

Komente

Pppulli: 10/07/2022 15:58

Kriminelet ne arrest shtepie ata qe nuk kane me se te paguajne dritat dhe ujin arrest me burg keto jane gjykatat tona qe jane kthyer ne merkato

Përgjigju

Turi: 10/07/2022 15:45

Gjykatat jane te korruptuara si cdo gje tjeter ne kete vend qelbesire , dhe pastaj ndodhin krime

Përgjigju

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Problematikat në plazhe, mendoni se Shqipëria ka bërë si duhet 'detyrat' për këtë sezon turistik?

Po | Jo | S'kam mendim

Lajme të tjera

Sociale

Filonazistët grekë hyjnë në Shqipëri për arin e Luftës së II Botërore! Report Tv sjell pamjet ekskluzive nga kërkimet në jug
Arsen Rusta
10 Korrik, 16:22

Kronikë

Mori shtëpi me qira në Sarandë dhe shpërndante kanabis për pushuesit! Arrestohet i riu nga Gjakova
10 Korrik, 15:35

Kronikë

I mori ryshfet qytetarit për t'i dhënë një dokument, arrestohet topografi në Vlorë
10 Korrik, 09:57

Kronikë

Pas 12 orësh kërkime, gjendet turisti gjerman së bashku me qenin e tij
10 Korrik, 08:31

Kronikë

Vlorë/ Humb turisti gjerman në Karaburun, policia në kërkim të tij
9 Korrik, 22:44

Sociale

Në kulmin e sezonit turistik, asnjë plazh i dezinsektuar, tenderi i pezulluar prej 3 muajsh! Pushuesit në Orikum: S'dalim dot në darkë
9 Korrik, 20:59

Kronikë

Kontrolle në aksin Kardhiq-Delvinë, pezullohen 20 leje drejtimi për shpejtësi mbi normat! Në 48 orë gjobiten 266 shkelës
9 Korrik, 17:30

Kronikë

Vetëvritet me armën e shërbimit efektivi i policisë në Delvinë
8 Korrik, 22:04

Sociale

Vëzhgimi i Report Tv/ 105 mln lekë investime, 'Syri i Kaltër' s'ka ende parkim dhe tualetet janë pa ujë! Pa zgjidhje për transportin, vizitorët ecin 2 km
Limos Didani
8 Korrik, 16:22

Kronikë

Sekuestrohet pallati 8-katësh në Vlorë, shpallen në kërkim dy pronarët! Leja e ndërtimit me dokumente false, një pjesë e truallit tokë shtet (VIDEO)
8 Korrik, 10:44

Politikë

Rama vizitë në sheshin e 'Flamurit' në Vlorë: Do bëj një seri me pllaka bronzi, secila të mbajë emrat e firmëtarëve të Pavarësisë
8 Korrik, 09:24

Politikë

Hapet i përfunduar për qarkullimin e automjeteve bypass-i i Vlorës, Rama kritika: Pse nuk ka ndarëse kjo?
7 Korrik, 20:43

Lajmi i fundit

A mundet që e paimagjinueshmja sot, të kthehet në të paevitueshmen nesër
10 Korrik, 17:10 nga Arbër Hitaj

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje